



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 634 Prot.

Tiranë, më 7/6 2016

Lënda : *Kthim përgjigje Tuajës nr. 2987/1 prot. datë 01.06.2016 "Mbi listën e qytetarëve që kanë kryer check-up".*

Drejtuar: **Z. Alfred ÇARERI**
Sekretar i Përgjithshëm
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Tiranë

I nderuar Z. Çareri,

Zyra e Komisionerit, ka marrë në shqyrtim kërkesën tuaj për mendim, në lidhje me kërkesën e një deputeti të Parlamentit Shqiptar, nëpërmjet të cilës është kërkuar lista e detajuar e qytetarëve që kanë kryer check-up dhe në këtë kuadër lutemi, referohuni në interpretimin ligjor përkatës.

Bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 8550, datë 18/11/1999 "Për statusin e deputetit" i ndryshuar, deputetit mund t'i vendosen në dispozicion të gjithë informacionet që kanë të bëjnë me dokumenta zyrtarë, dhe me ushtrimin e funksioneve publike (grupet e punës). Ndërkohë lista e qytetarëve, e cila i bashkëlidhet informacionit, si dhe lista e miratuar e qytetarëve që kanë kryer check-up, (mujore dhe vjetore që nga nisja e check-up), me identitet të plotë të tyre nuk mund të vendoset në dispozicion, për shkak se përmban të dhëna personale dhe bie në kundërshtim me respektimin e privatësisë së subjekteve referuar dispozitave të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Megjithatë, ky informacion mund të vendoset në dispozicion në formë statistikore.

Ky ligj përcakton detyrimin për përdorimin e të dhënave personale dhe të dhënat shëndetësore janë të dhëna sensitive (neni 7), që kërkojnë rregulla më strikte përpunimi. Kontrolluesi i cili ka mbledhur këto të dhëna duhet të respektojë parimin e përpunimit sipas qëllimit të mbledhjes së të dhënave. Në këtë kuadër, neni 8 "Për statusin e deputetit" i ndryshuar, nuk mund të aplikohet në kundërshtim me akte të tjera ligjore në fuqi, sidomos me ligjin specifik që rregullon dhe garanton mbrojtjen e privatësisë së shtetasve.

Gjithashtu, edhe në kuadër të së drejtës për informim sipas Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 17, kufizon dhënien e informacionit kur kjo vjen në kundërshtim me çënimin e jetës private të shtetasve.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI

